# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-437054**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Vuçiç zbulon kur do të japë dorëheqjen – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/vucic-zbulon-kur-do-te-jape-doreheqjen/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 14:57:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 14:57:20 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `550d6f2fdcf9d7e189f17ed89a20bd8e3f517cc1e5961196eb2e9d422ff1c922` |
| TEKSTI | `7518dff95661f802c0fc7eb0411a090caf94d79ac0a9d24f4a3c7c4b73126ce2` |
| PAMJA | `aefc190482793b40376d066b7c69a208d5f7ebe557fdf5be87189c96599a1e0c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `53e17875ea9a90b5a6b06acf18502484d6cc1d4adbe4ffc2cdd959a0f1d888b7` |
| E MËPARSHMJA | `11867b3b1c494971fbdf91d9c8b898b772a40ffa932a17028d5e514a7974e5a2` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/53e17875ea9a90b5a6b06acf18502484d6cc1d4adbe4ffc2cdd959a0f1d888b7`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

zakonshëm".

5 Elbasani nuk fal! Egnatia pëson humbjen e parë të sezonit

Vuçiç tha se vendimi nuk lidhet me një detyrim ligjor, por me një zgjedhje personale. Sipas tij, menjëherë pas kthimit nga Nju Jorku, ku do të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, do të largohet nga posti dhe do t'i bashkohet fushatës elektorale

"Nuk dua të bëj fushatë si President i Republikës. Dua të jem i pari që hyn në garë si një qytetar i zakonshëm", u shpreh ai, duke shtuar se muajin e fundit të fushatës do të udhëtojë nëpër Serbi me makinën e tij dhe me një kamionçinë të marrë me qira, për t'u takuar me qytetarët.

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Deklarata vjen vetëm pak ditë pasi Vuçiç shpërndau Kuvendin e Serbisë dhe shpalli zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare të 25 tetorit. Më 5 shtator, Partia Progresive Serbe e propozoi njëzëri si kandidat për kryeministër dhe bartës të listës zgjedhore, duke konfirmuar se ai do të udhëheqë fushatën e partisë në zgjedhjet e ardhshme.

Prej muajsh, Vuçiç përballet me protestat e studentëve dhe opozitës, të cilët kërkojnë zgjedhje të parakohshme dhe përgjegjësi politike pas tragjedisë në stacionin hekurudhor të Novi Sadit, ku humbën jetën 16 persona. Presidenti serb i ka cilësuar vazhdimisht protestuesit si "bllokues", ndërsa gjatë muajve të fundit ka folur disa herë për mundësinë e dorëheqjes nga posti para përfundimit të mandatit të tij në vitin 2027, pa përcaktuar një afat konkret.

Nëse e realizon vendimin që njoftoi këtë të premte, Vuçiç do të largohet

nga posti rreth një muaj përpara zgjedhjeve parlamentare, duke hyrë zyrtarisht në garë për postin e kryeministrit.

Gjatë konferencës për mediat, presidenti serb tha gjithashtu se në fjalimin e tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së do të flasë për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit në rajon. Ai u shpreh se bota po kalon një periudhë të pasigurt, me konflikte që po zgjerohen dhe me një rend të ri ndërkombëtar që, sipas tij, ende nuk është konsoliduar.

#doreheqje #VizionPlus #Vucic


**Taulant Halili**

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.


Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



RAJONI

**Kishte dalë nga burgu me leje dhe duhej të...**

Xhuljana Zhuleku · 1 orë më parë



KOSOVA

**Kosova me Qeveri të re! Kuvendi miraton...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 17:49



KOSOVA

**Pas konstituimit të Kuvendit, Albin Kurti...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 15:26

Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE

**Lajme**
- Politikë
- Bota
- Vendi
- Kronikë
- Lifestyle

**Programe**
- Programe
- Seriale
- Guida TV
- Video
- Ekipi i Vizion Plus

**Rrjeti**
- Rreth nesh
- Karriera
- Kontakt
- Reklamo me ne
- Dërgo lajmin tënd

**Ligjore**
- Kushtet e përdorimit
- Privatësia
- Cookies
- Politika editoriale


© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara


vizionplus.tv · Kthehu lart ↑

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.